



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 117 /2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Muhamet Rexha anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Ferizaj, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Ferizaj, për shkak të parregullsive gjatë procesit të votimit, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Ferizajt, në seancën e panelit të mbajtur me 03.05.2012, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Ferizaj.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 30.04.2012, nga subjekti politik LVV, me të cilën pretendohet se më datë 29.04.2012 në Qendrën e Votimit (QV) 2505D Nerodime në shkollën “Konstantin Kristoforidhi”, militantë të PDK-së, kanë hyrë në këtë QV, pa qenë të autorizuar, ku sipas parashtruesit të ankesës ndër këta militantë është edhe një zyrtar i subjektit politik, PDK me emrin Fehmi Reka. Sipas parashtruesit të ankesës është bërë shkelje e nenit 177 të Kodit Penal dhe Rregullës Zgjedhore 09/2009 neni 2.8.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Me ankesën e parashtruar në PZAP pretendohet se në QV 2505D, militantë të subjektit politik PDK-së, kanë hyrë në këtë QV pa autorizim. PZAP-i gjeti se pretendimet e tilla ankimore nuk qëndrojnë për faktin se në ankesë nuk janë dhënë prova dhe dëshmi të cilat eventualisht do ti argumentonin pretendimet e tilla ankimore, andaj duke marr parasysh këtë, në kuptim të nenit 115.1 lidhur me 118

paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

A nr. 117/2012 më datën 03.05.2012.

**Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shata**

